

NJOFTIM PËR MEDIA

Gjyqtarë austriakë, vizitë në Gjykatën Administrative të Apelit

Më datë 02.10.2025, një delegacion prej 29 gjyqtarësh administrativë nga Austria, u mirëprit në Gjykatën Administrative të Apelit, në kuadër të programit 2-ditor të vizitës së tyre studimore në institucionet e drejtësisë shqiptare, organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Shoqatën Evropiane të Gjyqtarëve Administrativë dhe Shoqatën Austriake të Gjyqtarëve Administrativë.

Delegacioni u prit fillimisht nga Z.Ardian Dvorani, në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe u njoh nëpërmjet tij, me historikun e kësaj gjykate, kategorinë e mosmarrëveshjeve që shqyrtohen prej saj, si edhe me praktikat gjyqësore respektive.

Gjatë kësaj vizite, gjyqtarët austriakë ndoqën me mjaft interes, seancën e parë përkatëse, drejtuar nga gjyqtare Blerona Hasa, lidhur me çështjen administrative të juridiksionit fillestar, vënë në lëvizje nga Prefekti i Qarkut Korçë kundër vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Kolonjë, që ka miratuar dhënien në përdorim/qira të një sipërfaqe të fondit kullosor, për ndërtim impianti fotovoltai.

Kjo vizitë shërbeu si mundësi për shkëmbim përvojash, në funksion të forcimit të lidhjeve mes institucioneve gjyqësore të Austrisë dhe Shqipërisë dhe ndërtimit të një sistemi drejtësie sa më efikas.



Gjykata Administrative e Apelit Tiranë